



**Ta ruajmë të pastër, të bukur dhe të blertë, Steblevën tonë**

# STEBLEVA



**Moj e bukura Steblevë, me para nuk blihesh ti**

GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.8. Qershor 2008. Çmimi 50 lekë.

## EDITORIAL

**SHOQATA "STEBLEVA"  
AVOKATJA E VETME PËR  
MBROJTJEN E INTERESAVE  
TË STEBLEVASVE**




Nga Mersin Hoxha  
Kryetar i Shoqatës

Sic e dini, në Steblevë dhe në Gollobordë ka shumë shoqata, por sic e kam theksuar edhe në numrat e tjerë të gazetës sonë "Stebleva", Shoqata "Stebleva" është e vetmja shoqatë që mbron direkt interesat e qytetarëve të Steblevës kudo që janë në fshat dhe në të gjithë Shqipërinë, bile edhe në botë. Në përputhje me interesat kombëtare dhe ligjet e shtetit shqiptar shoqata jonë ka mbrojtur dhe mbron interesat politike, ekonomike dhe sociale të qytetarëve të saj, pra është avokatja e vetme për mbrojtjen e interesave të steblevasve. Vetëm tre vjet jetë dhe veprimtari të shoqatës sonë kanë mjaftuar për të arritur balance pozitive dhe arritje në mbrojtje të pronave, tokave, pyjeve dhe të gjitha resurseve të këtij vendi të mrekullueshëm. U bënë përplasje të forta dhe konfrontime me keqbesuesit dhe hajdutët e pyjeve tona nga zotërinjtë Ali Fejza, anëtarët e kryesisë së shoqatës dhe nga banorët e Steblevës. U bë një sensibilizim i plotë dhe i gjithanshëm për shqetësimet e banorëve të Steblevës me pushtetin qendror dhe vendor, me të gjitha institucionet duke filluar nga ato kombëtare e deri ndërkombëtare.

(vijon në faqen 2)

# STEBLEVA SHPALLET PARK KOMBËTAR

Këshilli i Ministrave në mbledhjen e tij të datës 21 maj 2008 miratoi shpalljen "Park Kombëtar" të ekosistemit natyror Shebenik-Jabllanicë sipas përcaktimeve të bëra në hartën, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në veri pika e takimit të rrugës automobilistike Librazhd-Steblevë me rrugën Librazhd-Dorëz, me koordinata 4441509.41L/4564276.59V, ura e lumit Rapun, pranë fshatit Zgozhd, Shkalla e Lunikut, fshati Llangë, Fushë Studna. Kufiri verior ndjek rrugën e fshatit Borovë, në kuotën 887 m, përronin e Zallit të Klenjës, ndërpret rrugën automobilistike Steblevë-Klenjë, në kuotat 1328 m, 1462 m, 1484 m, 1484 m, 1778 m.



## MIRATOHET NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT TË STEBLEVËS

(Miratohet edhe skema e plotë e ndërtimit të tre hidrocentraleve në basenin ujor të zonës Steblevë-Borovë-Sebisht)

FAQE 2

**Në këtë numër  
do të lexoni:**

### KUJTIME PËR Steblevën

Nga Xheladin Ferhati  
FAQE 2

### KUR BIJTË KTHEHEN NË VENDLINDJE

(Reportazh nga Stebleva në  
ditën e Shëngjergjit)

Nga Sakip Cami  
FAQE 3

### Mustafa Qemal Ataturku dhe origjina e tij nga Stebleva

FAQE 4-5

### PRONONCIMI KRISTO FRASHËRIT PËR GOLLOBORDËN

FAQE 6

### MASAKRA SERBE E QAF PERVALLIT

FAQE 7

### Nga festa e 6 majit në Steblevë

FAQE 8

REDAKSIA E GAZETËS "STEBLEVA". Drejtor: Mersin Hoxha/ Redaktorë: Halil Kurti, Asjap Gruda, Vilma Disha, Artan Lila, Reshat Gruda. Kryeredaktor: Sakip Cami





**SHOQATA "STEBLEVA"  
AVOKATJA E VETME PËR  
MBROJTJEN E  
INTERESAVE TË  
STEBLEVASVE**


(Vijon nga faqja 1)

Kujtojmë vizitat e specialiste të pyjeve të Bankës Botërore për mbrojtjen e masivët pyjor dhe resurseve natyrore të Steblevës të cilat kanë dhënë rezultatet e para. Pas takimit me Ministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave zotin Luftër Xhuvëli, me nxitjen e Shoqatës "Stebleva" dhe me propozimin e kësaj ministrie Qeveria kohët e fundit e ka shpallur këtë masiv "park kombëtar". Qeveria gjithashtu ka marrë edhe një tjetër vendim të rëndësishëm për të ardhmen ekonomike dhe turistike të Steblevës, ka miratuar ndërtimin e tre hidrocentraleve me koncension, njëri prej të cilëve tashmë ka filluar. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ka planifikuar dhe ka filluar tashmë sistemimin dhe asfaltimin e rrugës nacionale Librazhd-Steblevë-Shupenzë. Zëvendësi Drejtor i Përgjithshëm i Rrugëve Skënder Çota e ka ndjekur nga afër këtë investim të rëndësishëm me karakter strategjik. Ne si shoqatë jemi gjithnjë në ndjekje të situatës dhe të realizimit të objektivave dhe të kërkesave të anëtarëve të shoqatës sonë, të mbarë qytetarëve steblevas. Tapia origjinale e tokave dhe pyjeve të Steblevës e vitit 1937 i është dorëzuar organeve të Pushtetit Qëndror, gjë që flet për seriozitetin dhe kërkesat e larta institucionale të shoqatës sonë. Bashkëpunimi me pushtetin vëndor, prefekturën, qarkun, dhe me organet e pushtetit qëndror ka qenë çelësi i punës sonë, bashkëpunim që do ta rritim akoma më shumë. Puna jonë vazhdon. Kërkojmë më shumë mbështetje nga të gjithë.

## MIRATOHET NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT TË STEBLEVËS

(Miratohet edhe skema e plotë e ndërtimit të tre hidrocentraleve në basenin ujqor të zonës Steblevë-Borovë-Sebisht)

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë me Vendimin Nr 431 datë 8.4.2008 miratoi kontratën e koncensionit, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transmetim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës dhe Shoqërisë "Stebleva" SHPK për ndërtimin e hidrocentralit "Steblevë". Administratori i shoqërisë "Stebleva" është zoti Ali Fejza, një biznesmen i njohur nga Stebleva. Kohët e fundit në kuadrin e strategjisë për sigurimin e plotë dhe të sigurtë të energjisë elektrike, Qeveria ka miratuar një sërë kontratash me shoqëri akcionere për ndërtime hidrocentrale të vegjël në të gjithë vendin në veri dhe në jug. Gjatë një takimi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës zotit Genc Ruli me administratorë të shoqërive koncensionare të ndërtimit të hidrocentraleve të miratuara nga Qeveria, zoti Ali Fejza ka falenderuar Qeverinë dhe drejtuar nga zoti Berisha dhe konkretisht zotin Genc Ruli për iniciativat e tij për dhënien e ndërtimit me koncension të shumë hidrocentraleve në Shqipëri dhe konkretisht edhe të hidrocentralit të Steblevës, që është një vlerësim i madh për këtë zonë. Përveç kësaj Qeveria dhe Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës ka miratuar skemën e plotë për ndërtimin e tre hidrocentraleve në këtë basen ujqor që përfshin



Pamje nga puna për projektimin e ujëmbledhësit të hidrocentralit

zonën Steblevë-Borovë-Sebisht. Pra përveç hidrocentralit të Steblevës që tashmë ka përfunduar projektimin në terren, në këtë zonë do të ndërtohen edhe dy hidrocentrale të tjerë, pra tre hidrocentrale gjithsej ku do të sigurohen dhjetra mega vat energji elektrike që do të lidhet me sistemin kombëtar të transmetimit. Stafi i kësaj ministrie me profesionalizëm dhe përkushtim i ka ndihmuar firmat dhe shoqëritë koncensionare duke u bërë kështu nxitëse dhe përkrahëse të iniciativës së lirë private në fushën e energjisë ele-

trike. Këto ditë personeli inxhinjeringo teknik i shoqërisë "Stebleva" përfundoi projektin faktik dhe piketimin e bazenit ujqor që do të mbledhë ujërat e maleve të Kallkanit, Draganit dhe Stratorit ku nëpërmjet një kanali të mbuluar dhe një tuneli të nëndheshëm do të dërgojë ujërat në turbinat e e këtij hidrocentrali të ri aq të shumëpritur nga këto banorë.

Burimet financiare për ndërtimin e këtij hidrocentrali tashmë janë siguruar. Projekti dhe preventivi është gati. Është siguruar gjithashtu edhe kontraktimi i bazës materiale të hidro-

**Burimet financiare për ndërtimin e këtij hidrocentrali tashmë janë siguruar. Projekti dhe preventivi është gati. Është siguruar gjithashtu edhe kontraktimi i bazës materiale të hidrocentralit. Nga ky projekt do të punësohen 50 punëtorë nga komuna e Steblevës. Hidrocentrali ka një fuqi prej 3,4 mega vat dhe ndërtimi i tij do të zgjasë 18 muaj**

centralit. Nga ky projekt do të punësohen 50 punëtorë nga komuna e Steblevës. Hidrocentrali ka një fuqi prej 3,4 mega vat dhe ndërtimi i tij do të zgjasë 18 muaj. Sistemim-asfaltimi i rrugës nacionale Librazhd-Steblevë (Dibër), ndërtimi i 3 hidrocentraleve në këtë zonë dhe kthimi i kësaj zone në një zonë turistike janë objektivat e qeverisë demokratike për zhvillimin e kësaj zone rurale me bukuri e resurse të mëdha natyrore. Përveç këtyre zhvillimeve një hov të ri do t'i japë zhvillimit ekonomik të kësaj zone dhe hapja e pikës kufitare të Steblevës dhe Trebishtit, për të cilën kanë rënë dakord në parim të dy vendet fqinj, Shqipëria dhe Maqedonia.

**Halil Rama  
(Sipas gazetës "RD"  
të datës 22 maj 2008)**

Nga XHELADIN FERHATI

### Pak fjalë për fisin e Dishajve

Fisi i Dishajve në Steblevë është një fis i hershëm. Sipas të dhënave historike ata kanë ardhur pra tre shekujve nga Ulqini. I pari i tyre ka qenë quajtur Disho. Nga emri i tij ka marrë mbiemrin i gjithë fisi. Të parët e Dishajve Disho Dish, Ulvi Dish e tjetër u vendosën në lagjen e bukur që sot njihet si lagja e Dishajve, një vend piktoresk.

Dishajt e fundit të shek. 19 janë Jonuzi, Meco, Xhaferri dhe Destani (babai i Jakupit). Më vonë vijnë Garipi, Ajdini, Nexhmedini dhe motra e tyre Xhuvëre Dish (gruaja e Hasis Lilës, patriotit të madh të rilindjes sonë kombëtare, pjesëmarrës në ngritjen e flamurit më 28 nëntor 1912, i cili u vra në mënyrë barbare në Llakavicë nga serbët në vitin 1915.

Për patriotizmin e këtij fisi të shquar në luftë kundër turqve, serbve etj ka shkruar edhe shkrimtari Skënder Jasa, i cili ka marrë intervistë direkt nga Garip Dish në vitet 80. Garipi ishte një tregues popullor, një historian i vërtetë dhe njohës i zonës.

### Për Jakup Dishën

Në këtë mjedis atdhetar lindí dhe u rrit edhe Jakup Dish. Fatkeqësisht qysh 9 muajsh i vdes e jëma dhe motra më e madhe 7 vjecare. Për këto tregonte qysh kur ishte gjallë Fatime Dish (Hoxha), bashkëshortja e mësuesit të nderuar Islam Hoxha.



Me Jakupin kemi qenë shumë të lidhur, sodomos në periudhën kur punonim në sharrat e Steblevës.

Jakupi vinte shtatllartë, shpatullgjërë dhe me një forcë të paimagjineshme. Por kjo nuk e bënte të ashpër, përkundrazi ishte njeri fisnik dhe tejet i ndershëm. Nuk i binte askujt në qafë, por as nuk lejonte që t'i shkelte kush në kallo. Jakupi qysh në moshën 9 vjecare punonte dhe ngrinte gurë që s'i ngrinin burra të fortë. Qysh në atë kohë e ka ndërtuar shtëpinë e tij me punën e vet.

Ai punonte në punë të rënda si buldozer, në hapjen e rrugëve të reja të pyllit dhe në gurorë. E ruante mallin me fa-

natizëm dhe besnikëri se e kishte prodhuar me djersën e ballit. Por një herë një grup njerëzish të pandershëm deshën t'a vidhnin.

Jakupi u ndesh me to dhe pa e egzagjeruar i shpartalloi. Njërin e kapi për fyti me një dorë si leckë, tjetrin e vuri nën këmbë. Të tjerët as nuk guxuan t'i afrohen dhe as t'ja rrëmbenin mallin, por e lanë aty ku e kishin marrë. Për të marrë hak lajmërojnë mundësit e fshatit, shokët e tyre për të rrahur Jakupin. Lajmërojnë dy mundësi nga Trebishti për të rrahur Jakupin. I zenë pritë Jakupit tek gazemat e punëtorëve, të fshehur pas një gëmushe ahu.

Jakupi kaloi për rreth gë-

mushës ku ishin fshehur dy mundësit trebishtas. Por kur panë sopatën e mprehtë në duart e Jakupit menduan të largohen sa pa i parë njeri. Kishin një forcë të magjishme. Pas çlirimit kur Jakupi ishte roje në një depo në Durrës, aksidentalisht depoja merr zjarr. Ai nuk ishte fajtor, por dënohet dy vjet. Me punën e tij në burg, jo vetëm u lirua para kohe duke bërë vetëm disa muaj, por edhe u dekorua. Jakup Dish ishte një div i tillë që shkarkonte anijen më parë se vinci duke i shkarkuar thasët e miellit sikur të ishin bukë jo thasë. Bëmat e Jakupit kanë përmasa legjende. Ai ka ndërtuar vijën e ujit të fshatit, përmes Killavecit,

duke vënë nën ujë dhjetra hektarë tokë të lagjeve Uliaj, Lackaj dhe Dishaj. E bëri këtë kanal në kohë rekord dhe pa përfitime materiale. Pas mbarimit të kanalit bëri inagurimin e tij me orkestër duke fituar admirimin e të gjithë banorëve të fshatit. -O Xhelo, mos vdeksha pa realizuar edhe nja dy gjëra, më thoshte Jakupi. Dhe të dyja i realizoi. Ndërtoi kanalin e ujit vaditës për fshatin dhe ndërtoi një shtëpi jo më prej qerpici që t'a digjte serbi, por një shtëpi prej guri dhe horosani me llaç gëlqereje, e cila nuk prishet kurrë. Njëherë në shtëpinë time kur Jakupi sharronte trupat, të gjitha veprimet i bënte vetë. E lëvizte trupin e ahut sikur të ishte një copë dërrasë. Fëmijët e Jakupit u bënë të mbarë e të zot si i jati. Samiu me të cilin jemi vërsnikë punoi me ndershmëri për 40 vjet në Sharra, në të ftohtë dhe acar, Destani e Refiku po ashtu. Hysniu ka qenë ushtarak, tani merr me biznes. Vajzat sejcila më punëtoresh se tjetra. Nipi i Jakupit, Ariani jeton në Tiranë, merr me tregëti, kryen studimet e larta pa shkëputje nga puna dhe është i lidhur ngushtë me Steblevën. Mbesat e tij, vajzat e Bules, kanë mbaruar studimet në Angli për ekonomi dhe janë sistemuar edhe në punë atje. Tani edhe vajza e tretë fitoi konkursin për Mardhëniat ndërkombëtare në Angli. Ne krenohemi me këto vajza, bija të Steblevës.

(Vijon në faqen 7)



# KUR BIJTË KTHEHEN NË VENDLINDJE

(Reportazh nga Stebleva në ditën e Shëngjergjit)

**Një falenderim të vecantë për për mirmbajtjen e rrugës Librazhd-Steblevë**

Dita e shumëpritur e Shëngjergjit erdhi me vranësira dhe shi, por kjo nuk i pengoi bijtë të kthehen në vendlindje. Dhe në këtë kthim ndihmuan më së miri edhe punonjësit e mirëmbajtjes së Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së rrugëve nacionale të Librazhdit, të cilët riparuan rrugën, mbushën gropat dhe bënë lehtësisht të kalueshme rrugën nga Librazhdi në Steblevë, rrugë e paasfaltuar që për hir të së vërtetës duhet thënë që është bërë deri më tani merri i shoferëve dhe i pasagjerëve.

Pra një falenderim për mirmbajtjen e rrugës u takon këtyre punonjësve dhe drejtorit të kësaj ndërmarrjeje të cilët kanë sakrifikuar nga vetja e tyre për të na e bërë më të lehtë ardhjen në festën tonë. Për më tej ka menduar Qeveria, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve që e ka futur në planin e saj perspektiv asfaltimin e kësaj rruge më karakter strategjik.



natës. Disa festues qëndrojnë me dëshirën e tyre jashtë në natën e ftohtë, pranë zjarreve të bukur dhe në mes të lëndinave të pyjeve. Një fugon nga Tirana ka ardhur i përgatitur më së miri. Me vete kanë gjeneratorin elektrik, kanë magnefonin me bokse të mëdha, kanë çadra të reja e të mëdha, mbi të gjitha kanë shpirtin e tyre për të festuar e gëzuar. Ata këndojnë e

dojmë dëshirat e jetës. Vijnë të gjithë moshat, pleqtë, të rinjtë, gratë dhe vajzat, fëmijët, vijnë dhe marrin nga bekimi i tij.

Në këtë festë të bukur pagane vijnë të ftuar nga e gjithë Shqipëria. Ka ardhur Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Rrugëve, bir nga një fshat fqinj i Librazhdit, Skënder Çota. Vjen Nën Prefektja e Librazhdit, zonja Mimoza Qyra, Drejtori i Policisë së qarkut të Elbasanit, Agron Hyseni, drejtues të Pushtetit Vendor, të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së rrugëve, të Elektrikut etj. Kryetari i Shoqatës "Stebleva" Mersin Hoxha u uron mirëseardhjen. Edhe të ftuarit pasi bëjnë ritet e fshatit hedhin valle bashkë me banorët e Steblevës.

**Këngë, valle, hare.**

Ka ardhur orkestra më e mirë nga Elbasani e drejtuar nga një bir Stebleve, e cila me gjeneratorë e bokse të mëdhenj përhap tinguj

këngësh dasme. Dasmë e vërtetë. Të shumtë janë ata që kanë therur kurbanë, qingja e keca të njomë, që i pjekin në hell dhe i "shuajnë" me raki të fortë të bërë vetë ose BMW sic i thonë vendasit që i besojnë dhe e shijojnë prodhimin e tyre Bio. Por nuk mungojnë as birra, vera, uiski dhe red bull. Tregëtarët janë kujdesur që të mos mungojë asgjë.

Këto ditë po vazhdojnë piketimet e para për ndërtimin e një hidrocentrali me koncesion. Qeveria vendosi këto ditë që Stebleva të ketë hidrocentralin e saj. Do të shfrytëzohen ujërat e malit të Draganit dhe të maleve të tjerë dhe do të bashkohet e do të disiplinohen ato për të prodhuar dritë elektrike. Nëpërmjet një kanali nëntokësor që nuk do të çenojë asgjë dhe askënd, hidrocentrali i ri do të ketë ujë të bollshëm që më vonë do të jetë bazë edhe për ndërtimin e dy hidrocentraleve të tjerë që do t'i bashkohen rr-

jetit kombëtar të transmetimit.

Biznesmenët vendas që kanë bizneset e tyre në Tiranë dhe vende të tjera kanë plane perspektive për të bërë falas edhe një mulli bloje për fshatin. Edhe një teleferik ndoshta së shpejti do të shërbejë për alpinizmin dhe turizmin lokal dhe kombëtar. Janë ndërtoar katër kabinat e para për turistët verorë.

**Verimi i blegtorisë, një ndër punët e mira të steblevasve**

Një biznesmen steblevas ka sjellë për verim 300 krerë dele dhe qingja për të shtuar në peshë, për mish, qumësht e lesh. Ashtu si ai kanë sjellë edhe të tjerë shumë bagëti. Stallet mirëmbahen edhe gjatë dimrit që në verë të jenë gati. Barinjtë e Steblevës, ata që jetojnë në fshat e kanë kënaqësi dhe profesion blegtorinë, rritjen dhe mbarështrimin e tyre, sidomos gjatë verës ku shfrytëzohen kullotat e shumta të Steblevës dhe pyjet e saj që sic e kemi theksuar janë më të mëdhatë në këtë zonë. Në fund të sezonit veror, para se të bijë dëbora e parë bagëtitë zbrasin në vendet e ulta, të ngrohta, ndërsa qingjat e rritur meshkuj shfrytëzohen për mish.

**Përsëri për rrugën nacionale Librazhd-Dibër**

Përsëri theksi vihet tek rruga nacionale Librazhd-Dibër që kalon nëpër Steblevë. Vetëm asfaltimi i saj sa më parë bën të mundur që të zhvillohet turizmi, përndryshe turistët nuk do të sakrifikojnë aq shumë pa një infrastrukturë të plotë. Përsëri e merr fjalën Skënder Çota, zëvendës drejtori i përgjithshëm i rrugëve. Nuk është premtim, thotë ai, por realitet. E dëgjuat Kryeministrin Berisha në Sa-

parë është sistim asfaltimi i pjesës Librazhd-Qafë-Studen me një vlerë 49.598.394 lekë të reja. Punimet kryhen nga Firma "SH.A Rruga Ura Asfaltim Nr 2 Elbasan, Murati shpk. Fillimi 7.11.2007 dhe mbarimi 6.12.2008. Mbikqyrës punimesh firma S.P.I.T Tiranë Kilometri i parë është asfaltuar. Një rrugë e gjërë e standarteve ndërkomëtare. Ndërtimi kësaj rruge me këto parametra i shoqëruar edhe me hapjen e pikës kufitare të Steblevës në vendin e piramidës 30 do të përbente një bum zhvillimi për Steblevën dhe për të gjithë këtë zonë që duhet pranuar se ka mbetur shumë pas dore. Këto impenjime i ka nën-prefektja e Librazhdit Mimoza Qyra që siguron se do t'ja përcjellë këto shqetësime dhe kërkesa zhvillimi qeverisë, këto shqetësime i ka edhe kryetari komunës së Steblevës dhe të Fushë-Studnes Xhavit Borici. Bashkëpunimi me pushtetin qendror dhe vendor dhe me të gjitha strukturat shtetërore është në qendër të shoqatës "Stebleva" për të mirën e zhvillimit të kësaj zone që është perle natyrore dhe burim resursesh zhvillimi.

**Po për hapjen e pikës kufitare të Steblevës ?!**

Zoti Skënder Çota, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Rrugëve thotë se është edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit në Komisionin Qeveritar për hapjen epikave kufitare me Maqedoninë. Ky komision funksionon dhe bashkëpunon me komisionin e qeverisë Maqedonase. Po ecet paralel për një hapje normale, mbarimi i rrugës, përmirësimi i infrastrukturës dhe zgjidhja e problemeve të pronësisë mbi tokën. Shteti maqedonas patjetër do të nxitë hapjen e kësaj pike kufitare, që do të thotë në një fare mase një integrim normal të shqiptarëve e maqedonasve në familjen e madhe europiane ku përipiqemi të aderojmë së bashku.

Largohemi nga Stebleva duke vështruar pas. Nuk na lë malli. Nuk na lë merakun për tokën tokë që të parët na e lanë



**Që në datën 5 maj vërshojnë makinat drejt Steblevës. Kthehen bijtë.**

Makinat me targa TR, DR, DI, BZ, EL, LB etj ecin drejt Steblevës, këtij fshati që ka patur 300 shtëpi dhe që tani këto 300 shtëpi janë shumë por jo në Steblevë, por në të gjithë Shqipërinë, jo vetëm në Tiranë, Durrës, Elbasan, Librazhd, Dibër e Bulqizë por edhe në Shkup, Selanik e Stamboll bile edhe në Nju Jork. Makina të shumta, vetura fuori strada e fugonë vinë me datën 5 maj dhe vazhdojnë edhe të tjera në mëngjezin e datës 6 maj.

Përse në Steblevë festohet më shumë se kudo tjetër festa e Shëngjergjit? Kjo festë pagane ka një kuptim të vecantë për steblevasit. Ata nuk arrijnë ta festojnë 14 marsin, ditën e verës sepse këtu dimri i madh dhe dëbora largohen vetëm në fund të prillit dhe fillim të majit. Edhe lulet e verës i mbledhin më 5 maj. Gjallëri dhe drita ka në të gjitha shtëpitë e Steblevës që nga data 5 maj që janë populuar në mënyrë të tejskajshme, me miq e dashamirës të shumtë.

Festa vazhdon edhe gjatë

kërcejnë të lirë e të kënaqur.

Policët kufitare sigurojnë mbarëvajtjen e festës. Shefi i policisë kufitare të Steblevës Astrit Ballgini dhe policët Sefedin Qoshi, Kujtim Albajrami, Petrit Koci e Përparim Kaca ndodhën midis tyre gjatë të dy ditëve dhe gjatë tërë natës që të mos ketë asnjë incident e shqetësim gjatë kësaj feste të madhe.

**Të pish pak ujë të bekuar tek Vakëfi i Steblevës**

Kemi folur për bukuritë e Steblevës por nuk kemi folur për Vakëfin e Steblevës dhe ujin e bekuar të tij. Në anë të rrugës automobilistike kombëtare, në të dalë të postës kufitare të Steblevës është ky vend i bekuar që nuk e prek njeri vetëm e mirëmban dhe e respekton. Këto livadhe të blerta janë bërë për të pushuar njerëzit, ky burim nga goja e pyjeve është bërë për të pirë barinjtë dhe rrugëtarët në nevojë, këto ahe shekullore janë bërë për të lëshuar hije për të pushuar njerëzit. Afrohemi tek burimi që tashmë është kthyer në një çezëm të re e të bukur, pimë ujë, lajmë faqet dhe men-



randë kur e përmendi rrugën e Librazhdit dhe të Dibrës.

Në hyrje të rrugës Librazhd-Dibër shikon tabelën e punimeve të asfaltimit të kësaj rruge. Porositësi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Loti i

amanet. Largohemi për t'u kthyer përsëri por me më shumë investime, me më shumë të ardhura për banorët e këtij vendi të bukur e të virgjër.

**Sakip Cami**



# MUSTAFA QEMAL ATATURKU

(11mars 1881-10 nëntor 1938)

## Shqiptari nga Stebleva që u bë reformatori dhe krijuesi i Turqisë moderne

Mustafai ka lindur në Selanik më 11 mars të vitit 1881. I ati i tij quhej Riza. Llagapi i tyre ka qenë Conka. Tokat e Conkajve janë edhe sot në Steblevë. I pari tyre ka qenë Pirush Conka dhe ka emigruar në Selanik në vitin 1861. Rizai ishte nëpunës me shpirt praktik veprimi dhe me mprehtësi e krenari të cilat ja trashëgoi edhe të birit Mustafait.

Mësuesi i matematikës, i cili quhej edhe ai Mustafa, vendosi që ta thërriste Mustafa Qemal (Mustafai i shkëlqyer).

Mustafai ishte djalë i zgjuar por edhe disi i veçuar. Vendosmëria e tij e heshtur për tu bërë dikushi në jetë një ditë shpërtheu edhe hapur: "Do të bëhem, do ta shihni së shpejti." Pas shkollës së mesme në Selanik, në vitin 1895 ai u regjistrua në Liceun Ushtarak të Manastirit. Manastiri në atë kohë ishte bërë qendër revoltash kundër Perandorisë Osmane. Së bashku me Fetion, një shok nga Ohri mësonin anglisht dhe lexonin Volterin, Rusoin, Monteskjensnë dhe Robespierin. Lexonte aq shumë sa ja tërhoqën vemendjen se kjo ishte shkollë ushtarake dhe jo për letërsi.

Mbas Liceut ushtarak të Manastirit, më 13 mars 1899 mori udhën drejt Stambollit, ku u regjistrua në kursin e këmbësorisë të shkollës ushtarake. Stambolli ky qytet i madh me kontraste të mëdha politike dhe ekonomike i bëri përshtypje të madhe dhe e forcoi akoma më shumë formimin e tij politik.

Dikur ai i pat thënë një fisniku të huaj: "Nuk jam fisnik si ju, por kam dalë nga gjiri i një populli fisnik." (Revista "Bota e Re" Nr 7 Korçë, 1937)



### RRËNJËT E TIJ NGA STEBLEVA E DIBRËS

Pleqtë Vahit Ereqi dhe Destan Bala nga Stebleva e Dibrës tregojnë se babai dhe gjyshi i Mustafa Qemal Ataturkut ka qenë nga Stebleva.

Ata janë larguar në emigrim në Selanik. Atje ka lindur Mustafa Qemali.

Tokat e tyre në Steblevë janë edhe sot, tokat e Conkajve poshtë malit të Osojit. Vetëm për të ndërtuar çezmën në vendin e quajtur Terzicë, Mustafai ka paguar dy qese me flori. Rrënjët e tij shqiptare prej fshatit Steblevë të Dibrës i tregon edhe ngjarja që po ju tregojmë:

Një steblevas nga Bandajt në Stamboll në një kafe vret Prefektin e qytetit sepse ai shan Shqipërinë. E dënojnë me vdekje. Një grup steblevas shkojnë të Qemal Ataturku dhe i kërkojnë që t'i falë jetën.

Mustafa Qemali ka thënë: "Për ta vrrarë nuk e vrasim, por jam i detyruar ta internoj".

### MUSTAFA QEMAL ATATURKU DHE SHQIPËRIA

Mustafa Qemal Ataturkut, sekretari i solli për të firmosur një listë me emrat e disa shqiptarëve, që do të shpërn-

guleshin nga Turqia.

Ataturku, pasi lexoi emrat, mori stilolapsin dhe në krye të listës vuri emrin e tij.

-Zotëri, nuk e kuptoj, përse e vutë emrin tuaj në krye të listës, pyeti sekretari i habitur.

-E vura, sepse i pari që duhet të shpëngulem nga Turqia, duhet të jem unë, sepse edhe unë jam shqiptar, u përgjegj Ataturku.

### SHPËRNGULJA NGA SHQIPËRIA

Në vitin 1861 janë larguar nga Stebleva e Dibrës 14 familje për në Selanik, ndër to edhe familja e Pirush Conkos dhe Vesel Kuçukut. Familja Kuçuku pas 40 vjetësh kthehet në Shqipëri, por jo në Steblevë, por në Tiranë, ku banojnë edhe sot. Kolegu im ushtaraku Halil Kuçuku vazhdon të shërbejë në rradhët e Forcave të Armatosura Shqiptare në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ndërsa familja e Pirush Conkos largohet nga Selaniku dhe vendoset në Stamboll rreth vitit 1900. Djali i tij ka qenë Rizai, babai i Mustafait, i cili mori për mbiemër fjalën "qemal" që do të thotë i shkëlqyer sepse i shkëlqyer në studime ishte realisht Mustafai. Pra nipi i Pirush

Conkajt, Mustafa Qemali u bë ushtarak i lartë, gjeneral dhe më vonë Presidenti i Turqisë së Re.

Në vitin 1936 është zhvilluar në Steblevë gjyqi për pronësinë e truallit të Conkajve. Gjyqi me gjyqtarë të ardhur nga Tirana dëgjoi deponimet e tre pleqve të fshatit Vesel Kuçuku, Sadik Kuburit (nip tek dera e Conkajve) është trualli i Pirush Conkos, gjyshit të Qemal Ataturkut. Gjyqi u zhvillua ndërmjet Jas-har Lamës dhe Faslli Kuburit dhe u fitua nga ky i fundit, pasi ky ishte nip tek Conkajt dhe i vetmi i afërt që kishte mbetur.

**Pra themelet e shtëpisë së Pirush Conkos, gjyshit të Qemal Ataturkut janë këto ku sot është shtëpia e Faslli Kuburit në Steblevë.**

### TAKIMI ME QEMAL ATATURKUN DHE PËRIMIN E TIJ

Në vitin 1926 Dail Ereqi nga Gjinoveci dhe Xhel Agushi nga Stebleva, kurbetli dhe specialistë ndërtimi në Stamboll janë takuar rastësisht me Qemal Ataturkun.

Ndërsa po punonin për restaurimin e një xhamie ata kanë marrë përgëzimet e kryetarit të shtetit turk Qemal Ataturku.

-Punë të mbarë, o ustalarë, i përshëndet Qemali.

-Mbarësi e mirësi paç, o njeri, ju përgjigjen me respekt, por pa e ditur se kush ishte por vetëm duke e marrë me mend sepse ishte i shoqëruar nga njerëz që e ruanin.

-Ju lumshin duart, qenkeni mjeshtër të zot e duar artë. E paskeni bërë më të mirë se ç'ka qenë para shkatërrimit nga lufta. Nga ju kemi ?

-Nga Shqipëria, i përgjigjemi.

-Po nga çfarë krahine ? pyeti prapë ai.

-Jemi nga Golloborda, njëri nga Gjinoveci dhe tjetri nga Sebishti, ju përgjigjëm, pasi u bindëm se ai e njihte mirë Shqipërinë dhe pasi kishim marrë komplimentat për punën e mirë.

Ataturku nxorri nga xhepi një bllok dhe na tha: "Edhe unë andej jam, nga Stebleva. Gjyshi im më ka lënë amanet arën e Conkajve, të cilën e shprehu në maqedonisht "Conkojca Ograda".

-A keni ndonjë nevojë ?

Ishte rasti për t'u shprehur, Kishte ardhur e mira tek dera. -Mbetëm kurbetçinj, gjithë

jetën pa familje, i thamë.

Kaq u desh dhe na u bë menjëherë nështetësia turke dhe na u dha banesë bile edhe më të mirë se vetë turqit.

### EKSPOZITË NË TIRANË KUSHTUAR ATATURKUT

Në vitin 1984, në kuadrin e 60 vjetorit të formimit të shtetit të ri turk, u hap në Pallatin e Kulturës në Tiranë, një ekspozitë kushtuar Turqisë moderne dhe arkitektit të këtij shteti modern Ataturkut. Edhe në pemën e gjenezës së familjes së Qemal Ataturkut vërtetohet origjina e tij shqiptare dhe vendlindja etij në Selanik. Ciceroni i ekspozitës shtetas turk me origjinë kosovare pohoi nën zë se Ataturku është me origjinë nga Dibra e Shqipërisë, tregon Ramazan Hoxha, autor i librit: "Stebleva, histori dhe figura"

### SIMBOLET NË EMRIN E TIJ

Nga emri i tij i tanishëm Mustafa Qemal Ataturk, vetëm emri Mustafa është emri i tij i vjetër. Qemal e ka marrë për mbiemër për faktin se ishte qemal (kemal) turqisht do të thotë i shkëlqyeshëm dhe me të vërtetë të gjitha studimet Mus-



tafai i mbaroi shkëlqyeshëm, por këtë emër ja dha mësuesi i tij i matematikës në shkollën e mesme që quhej edhe ai Mustafa, por që këtë nxënës e vlerësonte kemal (të shkëlqyer). Ataturk është emri apo pseudonimi që i vuri populli turk pas revolucionit që kreu në dobi të Turqisë moderne, pra i vunë emrin baba i Turqisë (Ataturk)

Mustafa Qemal Ataturku është i vetmi burrë shteti, emrin e të cilit e mban rendi që krijoi, sepse është themeluesi i Turqisë moderne. Ai bëri shëndrimin e Turqisë nga Perandori (Sulltanat) në Republikë.

Doktrina e filozofike e ideuar dhe e zbatuar shkëlqyeshëm nga Mustafa Qemal Ataturku është doktrinë e së ardhmes.

Për Mustafa Qemalin kategoritë "liri" dhe "pavarësi" qëndrojnë në themel të vetëqënies së popujve. Edhe sot në çdo cep të Turqisë do të shohësh thënieën e tij lapidare dhe aktuale "Një popull pa liri është i dënuar me vdekje ose të zhduket"

### *Themelet e shtëpisë së Pirush Conkos, gjyshit të Qemal Ataturkut janë këto ku sot është shtëpia e Faslli Kuburit në Steblevë*

Ai vinte drejtësinë mbi forcën, ndërsa i kushtonte rëndësi të dorës së parë forcës së brendshme të popullit.

Ataturku ka qenë mik i madh i Shqipërisë dhe i popullit shqiptar. Ai është me origjinë shqiptare (dibrane), lindur në Selanik dhe edukuar në shkollat ushtarake Turke të cilat do ta bënin gjeneral dhe udhëheqës të Turqisë moderne.

Ai nuk e mohonte këtë fakt, përkundrazi duke qenë i tillë, ai ishte mik i të gjithë popujve.

#### **KUSH ISHTE MUSTAFA QEMAL ATATURKU?**

Mustafai ka lindur më 11 mars të vitit 1881 në Selanik. I jati i tij quhej Ali Rizai. Llagapi i tyre ka qenë Conka. Tokat e Conkajve janë edhe sot në Steblevë. Ali Rizai ishte nëpunës me shpirt praktik veprimi dhe me mprehtësi e krenari të cilat ja trashëgoi edhe të birin Mustafait.

E ëma e Mustafait ishte Zybejde Hanëmi. Hanëmi është titull për gratë e asaj kohe dhe jo mbiemër. Ndonëse Zybejdja si të gjitha gratë e asaj kohe ishte e ndrydhur nga pikpamjet fetare, ajo punoi për edukimin e të birit dhe për pajisjen e tij me një arsimit modern. Meqenëse i jati i Mustafait vdiq shpejt, nëna e Mustafait mori fëmijët dhe shkoi tek i vëllai, i cili kishte emigruar më parë në një fshat pranë Selanikut të Greqisë.

E jëma megjithëse në kushte të vështira ekonomike e regjistroi Mustafain në shkollën e mesme, ku ai shkëlqeu veçanërisht në matematikë. Mësuesi i matematikës, edhe ai quhej Mustafa, vendosi që ta thërriste Mustafa Qemal (Mustafai i shkëlqyer).

Mustafai ishte djalë i zgjuar


por edhe disi i veçuar. Vëndosmëria e tij e heshtur për tu bërë dikushi në jetë një ditë shpërtheu edhe hapur: "Do të bëhem, do ta shihni së shpejti." Pas shkollës së mesme, në vitin 1895 ai u regjistrua në Liceun Ushtarak të Manastirit. Manastiri në atë kohë ishte bërë qendër revoltash kundër Perandorisë Osmane. Së bashku me Fetium, një shok nga Ohri mësonin anglisht dhe lexonin Volterin, Rusoin, Monteskejshën dhe Robespierin. Lexonte aq shumë sa ja tërhoqën vemendjen se kjo ishte shkollë ushtarake dhe jo

Pas shpërthimit të Luftës Ballkanike në tetor 1912, nga fundi i vitit 1913 filloi kontrolli gjerman mbi Turqinë, kontroll ky që ishte i padurueshëm dhe që e mbushi Mustafain me një dashuri dhe përkushtim për ti shërbyer Turqisë në këtë moment delikat të saj, por për të shërbyer jo më për Turqinë perandorake, por për Turqinë moderne sipas vizionit të tij modern.

Fillimi i Luftës së Parë Botërore e gjeti Mustafa Qemalin atashe ushtarak në Sofie. Më 2 shtator 1914 Perandoria Osmane hyri në luftë si aleate e

4-t dhe të qeveritarit të vilajeteve të Anadollit, detyrë me të cilën fitoi besimin e ushtrisë së mbetur. Ndonëse ai varej nga Ministria e Luftës, duke qenë edhe qeveritar për vilajetet e Anadollit kishte të drejtë të komunikonte direkt me autoritetet e Turqisë. Mustafai ishte personi kryesor që ishte në gjendje të kundërshtonte fuqitë e mëdha fituese të Luftës së Parë Botërore dhe të mos lejonte dobësimin e Turqisë si shtet. Për këtë ai fitoi edhe një mbështetje mbarë popullore.

Porta e Lartë e Stambollit



për letërsi.

Mbas Liceut ushtarak të Manastirit, më 13 mars 1899 mori udhën drejt Stambollit, ku u regjistrua në kursin e këmbësorisë të shkollës ushtarake.

Stambolli ky qytet i madh me kontraste të mëdha politike dhe ekonomike i bëri përshtypje të madhe dhe e forcoi akoma më shumë formimin e tij politik.

Më 1902, fill pas përfundimit të shkollës ushtarake, Mustafa Qemali hyri në Akademinë e Luftës. Me 11 janar 1905 Mustafa Qemali doli nga Akademia e Luftës me gradën kapiten. Ishte 24 vjeç. Bashkë me disa shokë morën me qera një apartament në periferi të Stambollit. Në jetën e tyre të lirë u shfaqën urrejtjet e para për rregjimin e vjetër turk të cilit i kishte kaluar koha. Ata themeluan një shoqatë të fshehtë të cilën e pagëzuan: "Atdhe e liri". Të rinjtë e kësaj shoqërie afishuan në pallatet e Sulltanit: "Jep dorëheqjen, o tiran! Mjaft e shfrytëzove këtë popull të mjerë".

Mustafai idetë e tij i theksoi edhe në poezitë që botoi në atë kohë, dhe për këtë e internuan në Damask me urdhër të Sulltan Avdyll Hamitit. Edhe në Damask formoi shoqërinë "Atdhe e Liri". Në nëntor 1906 kjo shoqëri funksiononte brenda dhe jashtë Turqisë dhe ishte e fuqishme.

Në shtator 1907 Mustafa Qemali u caktua në Shtabin e Armatës së III në Selanik, ku zgjeroi veprimtarinë e tij me ish shokët e tij të shkollës. Idetë e tij nuk ishin për Perandorinë Turke, por për Republikën moderne të Turqisë së vertetë.

Mustafa Qemali nuk kishte besim as tek xhon turqit. Ai u lidh me politikanët e internuar nga Sulltani.

Gjermanisë dhe Austrisë.

Mustafa Qemali në Çana Kala (Dardanele) mori drejtimin e Divizionit të 19-të në prill të vitit 1915.

Pas luftimesh të pandërprera, më 19 dhjetor 1915, forcat e Antantës u larguan përfundimisht nga Çana Kalaja duke humbur 250 mijë ushtarë.

Heroizmi që treguan forcat e komanduara nga Mustafa Qemali, shërbimet e mëdha që ato i sollën mbrojtjes së vendit, u përhapën anë e mbanë Turqisë. Kjo fitore do të kishte rrjedhoja pozitive për Mustafa Qemalin dhe për zhvillimet e mëvonshme në jetën politike të kombit turk.

Vitet 1918-1920 do ta evidentonin Mustafa Qemalin si luftëtar të madh në mbrojtje të atdheut, të Turqisë, e cila e kishte humbur luftën si aleate me Gjermaninë dhe Austrinë, ndaj rreziku i copëtimit dhe dëmtimit të shtetit turk ishte tashmë një rrezik serioz që do të vlerësohej nga Mustafa Qemali dhe nuk do të lejohet nga ai, për vetë autoritetin që kishte fituar në atë kohë.

Mustafai do të kthehej në Stamboll pas mbarimit të Luftës së II Botërore, mbas 30 tetorit 1918. Ai nuk pranoi vendimet e vendeve që fituan luftën në dëm të popullit dhe të shtetit turk, duke u shprehur: "Verdiktet e shpalluara pas shpine kundër atdheut e kombit tonë, janë të dënuara të mbeten pa efekt."

Pas vdekjes de fakto të Perandorisë Turke, filloi një epokë e re, personifikim i së cilës do të bëhej Mustafa Qemali, i cili që tani fillon betejën e tij për të krijuar një shtet të ri modern.

Më 30 prill 1919, Mustafa Qemali pranoi detyrën e inspektorit të Forcave të Armatës së

e shkarkoi atë, ndonëse edhe vetë ai nuk pranonte t'i shërbente kësaj qeverie të dështuar, trashëguese të Sulltanatit.

Pra ky general i shkarkuar de juro, de fakto kishte rreth vehtes të gjithë ushtarakët e lartë të ushtrisë.

Me 23 korrik 1919, pjesa më e madhe e delegatve të provincave lindore të Turqisë u mbledhën në Erzurum në një Kongres të jshhtëzakonshëm në kushte ilegale, krijuan një këshill kombëtar të kryesuar nga Mustafa Qemali. Asnjë urdhër për arrestimin apo dënimin e Mustafa Qemalit nuk mundi të zbatohet. Me vendimet e Kongresit të Erzurumit u njohën edhe vendet e Antantës, SHBA dhe Anglia. Në favor të veprimeve të Mustafa Qemalit reagoi edhe Shoqata e të Drejtave të Njeriut.

Aleatët u bindën se kishin të bënin me një lëvizje masive dhe nuk mund të rrinin indiferent ndaj saj. Me vendim të Komitetit Përfaqësues të drejtuar nga Mustafa Qemali me 27 dhjetor 1919, Ankara u bë qendra e luftës kombëtare dhe më vonë kryeqyteti i Turqisë moderne.

Forcat e Antantës nuk ishin dakord me vendimet e Parlamentit të Ri turk të janarit 1920 dhe me Paktin Kombëtar të tij për mbrojtjen e Turqisë dhe të Stambollit dhe e pushtuan atë. Fuqinë dhe drejtimin e mori Mustafa Qemali, i cili i përzuri forcat e Antantës dhe shpalli Ansamblenë Kombëtare të Turqisë si i vetmi pushtet ligjvënës në përputhje me Paktin Kombëtar për ruajtjen e teritorit të Turqisë.

Më 23 prill 1920 Ansambleja e Parë Kombëtare bëri mbledhjen e parë në Ankara. Kjo Ansamble zgjodhi kryetar të

saj dhe të Komitetit Ekzekutiv (Qeverisë) Mustafa Qemalin. Mustafai që në fillim zhvlehtësoi vendimet e Sulltanit, i cili ishte rob i Fuqive të Mëdha dhe çfuqizoi çdo marrveshje apo vendim në dëm të Turqisë, qoftë edhe vendimet në favor të këtyre fuqive. Kjo i acaroi shumë këto vende, të cilët u përpoqën që ta rrëzonin qeverinë e Mustafa Qemalit, por kjo ishte thembra e akilit për këtë lider mbarëpopullor.

Mbrojtja e teritorit të Turqisë, mos pagesa e reparacioneve të luftës nga Turqia e sh-

katruar ishin detyrat imediate të qeverisë së Mustafa Qemalit deri në fund të vitit 1922. Mustafa Qemali shkatroi sistemin e Sulltanatit dhe Kalifatit dhe formoi republikën. Kjo ishte një arritje e madhe, që e lejoi atë të fillonte dhe të zbatonte reformat e mëdha demokratike në të gjitha drejtimet, në edukim, drejtësi, financa, shëndetësi, kulturë, ushtri etj. Vitet 1924-1938 ishin vitet e këtyre reformave që krijuan Turqinë e re moderne që kemi sot.

#### **VLERËSIME PËR ATATURKUN**

Lidhja e Kombeve më 1938 e ka quajtur Mustafa Qemal Ataturkun, shërbëtor gjenial të paqes. Ataturku është i vetmi shtetar që kombi e ka quajtur baba të kombit. Sekretari i Përgjithshëm i OKB Kurt Valdhajm, në një fjalim të mbajtur më 30 shtator 1981 në selinë e OKB theksoi se Ataturku ishte "një nga njerëzit më të mëdhenj të shekullit, hero i çlirimit kombëtar dhe arkitekt i paqes."

Presidenti francez Eduard Herio që ka qenë edhe një shkrimtar i madh dhe që ka jetuar edhe në Turqi e quan Mustafa Qemalin një nga njerëzit më të mëdhenj që ka parë historia." Me laicizmin që futi Ataturku mbolli në shoqërinë turke lirinë shpirtërore, nënën e të gjitha mirësive, thekson Herio.

Vlerësimet për Ataturkun janë të pafundme nga njerëz të mëdhenj të të gjitha fushave dhe të të gjitha kontinenteve.

Dikur ai i pat thënë një fisniku të huaj: "Nuk jam fisnik si ju, por kam dalë nga gjiri i një populli fisnik." (Revista "Bota e Re" Nr 7 Korçë, 1937)

**Përgatiti: Sakip CAMI**



# PRONONCIM I KRISTO FRASHËRIT PËR GOLLOBORDËN



Në kuadrin e kartës së OKB, theksoi historiani Frashëri, ortodoksit e zonës së Gollobordës mbi bazën e vullnetit të tyre kanë të drejtën të vetdeklarojnë shtetësinë dhe kombësinë e tyre. Vetëm një gjë duhet patur mirë para sysh se toka e Gollobordës është tokë shqiptare dhe për mbrojtjen e saj nga pushtuesit serbë dhe bullgarë kanë dhënë jetën shumë patriotë të kësaj zone, kanë vdekur edhe gra e fëmijë

Gjatë ceremonisë së akordimit të titullit "Qytetar Nderi" nga Komuna e Arrasit e Dibrës, në Muzeun Historik Kombëtar me datën 26 maj 2008, Historiani Kristo Frashëri ju përgjigj edhe një pyetje të bërë për Gollobordën. Gollobordasit janë minoritet maqedonas, minoritet bullgar apo janë shqiptarë ?

-Historia shkruhet dhe argumentohet me dokumenta, theksoi Frashëri.

Në Gollobordë banojnë tre grupe njerëzish. Në Gollobordën Përendimore ka fshatra shqipfolës, identiteti i tyre as që vihet në dyshim që janë shqiptarë. Në Gollobordën Lindore ka fshatra dy gjuhë folës, shqip dhe bullgarisht. Rajoni i Vjetër i Maqedonisë ka qenë përbërë nga helenët, ilirët dhe thrakët. Pra nëqoftëse bëjmë fjalë për maqedonas etnikë, janë ilirët. Republika Jugosllave e Maqedonisë u krijua pas vitit 1945. Pra varianti i gjuhës maqedonase dhe etnisë maqedonase bie poshtë. Fshatrat e Gollobordës lindore flasin dhe shkruajnë shqip dhe vetëm e flasin bullgarishten e vjetër, e cila për hir të së vërtetës është mbushur me

fjalë shqipe. Problemi i dygjuhësisë ka ardhur si rezultat i pushtimeve bullgare. Për këtë problem ka botuar studimin e tij edhe historiani dibran nga fshati Trebisht Hilmi Sadiku. Dyndjet bullgare të shek VII dhe vecanërisht pushtimet bullgare të vitit 1916, raprezaljet dhe vrasjet masive shkaktuan terror dhe frikë në tokat shqiptare të Dibrës dhe vecanërisht në ato të Gollobordës për të pranuar edhe tutelën bullgare, pasi në këtë zonë banojnë edhe sllavë ortodoksë. Në kuadrin e kartës së OKB, theksoi historiani Frashëri, ortodoksit e zonës së Gollobordës mbi bazën e vullnetit të tyre kanë të drejtën të vetdeklarojnë shtetësinë dhe kombësinë e tyre. Vetëm një gjë duhet patur mirë para sysh se toka e Gollobordës është tokë shqiptare dhe për mbrojtjen e saj nga pushtuesit serbë dhe bullgarë kanë dhënë jetën shumë patriotë të kësaj zone, kanë vdekur edhe gra e fëmijë.

Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve pas vitit 1913 i përbërë nga italianë, francezë e rusë që ka vazhduar për ratifikimin e tyre deri në vitin 1920 ka marrë parasysh gjuhën shqiptare dhe

*Të ngresh teza të tilla dhe pretendime pa baza se në Gollobordë jetojnë qindra e mijëra bullgarë apo maqedonas, ndërkohë që Shqipëria, Maqedonia dhe Bullgaria janë pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Europian, janë teza shoviniste antishqiptare dhe njëkohësisht edhe antieuropiane, përfundoi fjalën e tij Profesor Frashëri*

kërkesat e kësaj zone me gjithë kundërshtimet e rusëve dhe për këtë ka fakte e dokumente, njerëz që kanë dhënë jetën në mbrojtje të kufijve. Për këtë problem unë kam patur debate edhe me historianë bullgarë dhe maqedonas.

S. Cami

## KËTA JANË STEBLEVASIT QË S'TË FALIN PËR NDER DHE ATDHE

Në gusht të vitit 1920 serbët mësyjnë përsëri zonën e Gollobordës. Kaluan Klenjën, Gjinovecin, Trebishtin dhe ju afruan Steblevës. Serbët kishin me vehte mercenarët e Xhem Kosturit dhe Daut Hodës.

Duke ju afruar steblevës ata provokuan me një këngë në gjuhën bullgarçe: "Nuse, moj syzezë/Çohu herët në mëngjez/Të bësh gati kalin dori/ Se do të shkosh në Serbi..."

Steblevasit që s'të falin për nder dhe atdhe ju përgjigjën me pushkë. Këtë betejë e fituan burrat e Steblevës, nën drejtimin e patriotit Adem Bojaxhiu, të ndihmuar nga fshatrat Borovë dhe Zabzun. Luftuan me trimëri e burrëri të pashoqe Imer Gjini, Tafil Banda, Elmaz Gruja, Avdi Avda, Zenel Çausi, Imer Kurti, Kurt Rada etj. Bashkë me burrat luftuan direkt në fushën e luftimit Hatiuxhe Kormaku, Sulltane Hoxha, Fatime Hoxha, Mejte Disha, Selime Bojaxhiu, Zylfije Murati etj.

KËNGA POPULLORE THOTË:

"Kraji i serbit ka urdhue  
Në Steblevë për me shkue  
Tanë katundin me rrethue  
Kambë burri mos me shpëtue...  
Gjithë Stebleva u ngrit në kambë  
Lidhën besë për me vdekë  
Plasi pushka flakë për flakë  
Shokët e Xhemës u banë me gjak  
Po shkon gjaku tuj kullue  
Daut Hoda ka mbarue  
Daut Hoda qofsh mallkue  
Ku i le shokët nat përrue  
Ca të vra , ca të palgue  
Gajret burra me qëndrue  
Vjen Borova tuj sulmue  
Vjen Zabzuni me ndihmue  
Plasi pushka ke stanet e Balës  
Porsi lufta e Çanakalës.  
Këto vende janë me huqe  
Kësulën ta bajnë të kuqe."

## Humor nga regjimi monist

### JEMI KEQ ME USHQIMIN E PËRDITSHËM

Ahmet Tamizi ishte punonjës biblioteke tek Sharrat e Steblevës. Në këtë stabiliment të madh punonin qindra punëtorë. Përvec objekteve social-kulturore kishte edhe menca për punëtorët. Ushqimi i punëtorëve linte për të dëshiruar. Mungonin asortimentet kryesore si mishi, djathi, vezët, etj. Por askujt nuk ja mbante të thoshte se ushqimi asht i keq se vepronte neni 55 i agjita-

cionit dhe propogandës kundër partisë dhe pushtetit popullor.

Nji ditë në Steblevë vjen nji ekip i Komitetit Qendror të Partisë për tu njohur me problemet dhe shqetësimet e popullit. - A keni ndonji ankesë apo vërejtje për punën, po ndonji hall ? pyetën shokët e ekipit të Komitetit Qendror.

-Po, kemi nji ankesë,

foli Ahmeti. Jemi keq me ushqimin e përditshëm. Shokët e ekipit të Partisë panë njëri tjetrin në sy. Kjo ishte bombë e hedhur para syve të tyre. Si do t'ja thoshin udhëheqësit të partisë ? Po ky i cmendur që po thotë a nuk e mendon se mund të rrezikojë burgun ? Po Partia asht shpirt gjanë me masat. Kur masat ja thonë direkt vërejtjet ajo nuk ka se si

t'i fusë në burg. Duhet gjetur marifeti, duhet evituar ky njeri i rrezikshëm.

-Pse nuk e keni të mirë ushqimin ? pyeti sa për t'u dukur i deleguari. Ahmeti e mori menjihërë kthesën. Nuk thashë për ushqimin e mencave se atë e kemi të mirë, por për ushqimin e përditshëm, për shtypin, gazetatat dhe revistat që ka dy ditë që nuk na ka ardhur.

Edhe i deleguari sikur shpëtoi nga ankthi i të raportuarit para Partisë. Shtypin do ta sjellim menjihërë, u zotua ai. Të lumtë Ahmet, që interesohesh për shtypin e Partisë. Kështu si ti, i do Partia njerëzit.

I shkreti Ahmet, shqyr që arriti ta ndrojë pllakën menjihërë se do të dergjej nja dhjetë vjet në burg.



## KUJTIME PËR JAKUPIN DHE FISIN DISHA



(Vijon nga faqja 2)

**Një ndodhi e rrallë, dasëm dhe mort në një ditë, dasma dhe mort motër e vëlla**

Ishte gushti i vitit 1980. Ish-te caktuar dasma e Hysniut. I kisha dhënë fjalën se do të vija në këtë dasëm. U nisa me një motor MZ së bashku me një mikun tim shkodran.

Arrijmë në Sharrë dhe takohemi me shumë bashkëshatarë. E dinim, por marrim vesh se një kushuri i Jakupit, që kishte kohë që ishte i sëmurë, ishte përkeqësuar shumë. Jakup Projku dhe Aqif Musliu me respekt na urojnë mirëseardhjen dhe na thonë se i sëmuri vazhdon në gjendje kritike.

Pushuam për disa orë tek shtëpia e mikut tim Hamit Fejzës. Dolëm tek lisi shekullor nga ku soditej ardhja e orkestrës së dasmës. Prej nga këtu Stebleva, kjo bukuri e rrallë natyrore duket si në pëllëmbë të dorës. Prej këtu shihet edhe ceremonia e flamurit kombëtar që është bërë traditë që nga 28 nëntori 1912, kur e ngriti për

herë të parë patrioti Hazis Lila.

Orkestra drejtohet për nga shtëpia e Aqif Musliut. Më shoqëron që nga Tirana dhe në cdo sekondë të dasmës miku dhe shoku im shkodran. Shkodrani më thotë i habitur: "Si e ke lënë Steblevën dhe ke ardhur në Tiranë? A lihet ky vend i bekuar?"

Dasma kishte filluar. Në mbrëmje vonë vjen lajmi i kobshëm, por që pritej nga casti në cast. Shahin Disha vdiq. Dasma mori një hije të rëndë. Gëzimi u ngriu njerëzve në buzë. Shahin Disha ishte djalë i ri. Lagja e Dishajve është si një ishull i blertë me pemë frutore e dru natyrorë të shumtë, me livadhe e lëndina që vazhdojnë deri tek vendi i quajtur Livadhli i turqve (vendi ku u është zënë pritë pushtuesve turq). Qindra vetë të ftuar, burra e gra, djem e vajza, pasi kanë marrë lajmin mbi vdekjen e Shahinit kanë heshitur sic heshtet para vdekjes.

Izoti i dasmës Jakup Disha kishte dhënë urdhër që orkestra të pushojë. Kishte vdekur djali i kushuririt të parë. Nga shtëpia e kushuririt të vdekur disa metra më larg kishin filluar vajtimet e grave.

Në mes të kësaj heshtje-

je dallojmë të vijë drejt nesh, drejt vendit të dasmës Garipen, nënën e djalit të vdekur. Më drejtohet mua dhe Sali Hoxhës me ton urdhërues: "Ngrihuni në kambë, të fillojë orkestra, të gjëmojë daullja dhe curlja se kam amanet nga djali. Sido që të ndodhë, nënë, të vazhdojë dasma."

E para heq vallen nënë Garipja. Pas u futën të gjithë në valle. Nuk mbeti njeri pa u përfshi në valle. Valle e gjatë, gati njiqind vetë. Këmbët na shkonin pa dëshirë, por kërcenim se dasma dhe mortin janë motër e vëlla, thotë populli.

E përqaftuam këtë nënë të madhe me shpirt të madh. Se cfarë kishte në shpirt e dinte vetëm ajo, por nuk jepej nëna nga Stebleva. Atë ditë, vetëm në atë dasmë u thye rregulli dhe u muar nusja para dite sepse mbas dite u ba varrimi i Shahinit. Kështu janë shqiptarët, dibranët dhe steblevasit, të paepur në cdo situatë. Vetëm kështu të bashkuar dhe të paepur i kemi bërë ballë jetës së vështirë dhe përpjekjeve të pushtuesve për të na robëruar.

### Tradita atdhetare

# MASAKRA SERBE E QAF PERVALLIT

**N**ë Qafën e Pervallit, midis Zabzunit, Okshtunit e Pervallit është një gropë që nuk është mbyllur edhe sot, as nga natyra dhe as nga njerëzit. Kjo gropë është varri i përbashkët i 300 luftëtarëve të Gollobordës në qershorin e vitit 1915 të

shkaktuar nga pushtuesit serbë. Është një gropë e mbushur me trupat e njerëzve, burra, gra e fëmijë, pleq e të rinj, e mbushur me gjak dhe me lotë. Gjak dhe lotë të banorëve të Steblevës, Zabzunit, Okshtunit, Pervallit, Klenjës, Ostrenit, Trebishtit etj që u ishin dje-

gur shtëpitë, që ngritën krye kundër pushtuesve serbë. Në këtë masakër u shuan familje të tëra nga Zabzuni, Studna e Llanga si ajo e Hasan Kalecit me 5 pjesëtarët e familjes, Agim Gjini me 6 pjesëtarë, Liman Gjini me 10 pjesëtarë, Hamza Stafa me 10 anëtarë, Arif

Xhafa me 8 anëtarë, Mersin Halili me 9 pjesëtarë e dhjetra të tjerë. Në këtë gropë u gropos për së gjalli Hoxhë Moglica. Vetëm disa ditë pas kësaj masakre, u organizua në Qaf Shkallë të Lunikut, qëndresa e luftëtarëve të Gollobordës dhe të fshatrave fqinj të Li-

brazhdit, Qarrishtë, Letëm, Lunik e Zgozhd. Luftëtarve u printe luftëtari trim nga Stebleva Islam Kurt Lama. Në këtë betejë u vra edhe komandanti serb, kapiten Kristo. Serbët në përpjekjen e tyre për të dalë në Elbasan e më tej në Durrës e paguan me kokat e tyre.

### Visare popullore

## Fjalë të urta nga Dibra dhe Stebleva

1. Ai që fyen të tjerët kërcënon vetveten.
2. Mirësjellja është lulja e njerëzimit. Fyerja është shprehje e dobësisë.
3. Të quash njeriun njeri është e lehtë, por të jesh njeri është e vështirë.
4. Fëmija ka nevojë për shëmbull personal dhe jo për vërejtje.
5. Bretkosën edhe në fron mbretëror ta vesh, përsëri do të hidhet në kënetë.
6. Njeriu i mirë le trashëgim të madh kur ka edukuar fëmijë të mirë.
7. Gosti më e mirë për mikun është nderimi dhe dëgjimi.
8. Fjalët nuk janë fajtoare. Fajtoarë jemi ne që i përdorim ato pa kriter.
9. Më shumë pendohet ai që flet pa menduar se sa ai që ka dëgjuar.
10. Njeriu që nuk frenon zemërimin është si një kala pa mure rrethues.
11. Atje ku ka grua të mirë ka edhe edukatë familjare e qytetare.
12. Askush nuk mund të

- zbusë një tigër duke e goditur atë.
13. Dëgjoje atë që të bën vërejtje për të metat e tua.
14. Kush nuk merret vesh me babanë, s'merret vesh as me dynjanë.
15. Sjellja e njeriut është një pasqyrë ku seicili ka fëtyrën e vet.
16. Njeriu i mënçur edhe kur është i zemëruar nuk bie aq poshtë sa të fyejë.
17. Miqësia e një njeriut të madh është mirësi e prindërve.
18. Ai që merr pjesë në hidhërimin tënd kurrë nuk është i huaj.
19. Ai që di shumë, beson.
20. Xhamia më e mirë është ajo e ndërtuar në shpirt.
21. Kur Zoti të dërgon grurë, ruaju djallit mos të të shpojë thesin.
22. Besimi është nëna e bujarisë. Besimi rrit kujdesin për të tjerët.
23. Kush beson Zotin nuk trembet nga armiqtë e tokës.

24. Përendia të ndihmon, kur edhe ti e ndihmon atë duke qenë i rregullt.
25. Zoti i bekon ata që bëjnë vizita dhe biseda të shkurtëra.
26. Feja e ka shtëpinë në mes të gëzimit.
27. Atij që duhet t'i trëmbesh është vetëm Zoti.
28. Mos u brengos për të nesërmen (të ardhmen), se për të kujdeset Zoti.
29. Kur nuk ke besim, më mirë mos fillo atë projekt që ke ndërmend.
30. Zoti është një, Muhameti është profeti i tij.
31. Nuk ka grua në botë, që s'dëshiron të shkaktojë konflikt sado të vogël.
32. Djali është në borxh të përjetshëm me prindërit e tij.
33. Fëmija është shprehje e përsosmërisë dhe bukurisë.
34. Kur të ndodh një aksident, më parë të ikën mendja.
35. I forti ka edhe fat.
36. Fati dhe rasti vinë rrallë.

37. Kur punon shumë ke edhe fat shumë.
38. Mos rri kot, por lëviz kot.
39. Fati ndihmon mendjet e ndritura. Ata dinë ta njohin atë.
40. Guximtari ka dorën e zgjatur drejt fatit.
41. Mos ja pështy fytirën babait krenar, se i mbetet në qafë përjetë, kular.
42. Ki pak frikë o djalë pa mend, se jeta nesër të shqyen në vend.
43. Mos prit prej meje uratë, kur zemrën time e thyen si shkarpë.
44. Mos bëj të këqija, që të mos të të bien të këqija.
45. Sillu si njeri dhe jo si fëmi lodrak që nesër të mos kesh frikë aspak.
46. Kush bimën e ha të njomë që në arë, mbetet edhe pa farë.
47. Po luajte bixhoz, edhe po fitove, prapë je i humbur.
48. Martesa është stadi i përsosmërisë morale.

49. Nëna është krijuese e dashurisë.
50. Mosmirënjohja e fëmijve është më e hidhur se pickimi i gjarpërit.
51. Martesa pa dashuri është si pema pa kokrra.
52. Shtëpinë pa fëmijë nuk e ka lakmi asnjëri.
53. Bota e nënës është botë shpirtërore pa kufi.
54. Zoti ka krijuar nënën të shpërndajë dashuri.
55. Vajzës bëji një kukull, që të përfytyrojë fëmijën e ardhshëm.
56. Më lehtë ndërton një pallat se sa rrit një fëmijë.
57. Fëmijë të vegjël rrit plot, të mëdhenjtë të bëjnë ty fëmijë.
58. Zinxhirët e martesës janë të rëndë, prandaj mbahen nga të dy bashkëshortët.
59. Misteret e gruas nuk zbulohen asnjëherë, zemërimi i saj nuk pranon logjikë.
60. Burri kënaqet me lumturinë që shijon, gruaja me lumturinë që sjell.
61. Kur mbyllet një portë e fatit, hapet njëkohësisht një tjetër.





# Nga dita e festës së 6 majit



*Vakëfi i Steblevës*



*Çaste pelegri nazhi*



*Ndërtohen shtëpizat e para për turistët*

Ky numër u sponsorizua nga z. Aranit Nura,  
numrat 6 dhe 7 u sponsorizuan nga z. Mersin Hoxha



Adresa : Rruga e Dibrës, prapa Akademisë Ushtarake "Skënderbej". Tel 04/271456, 0692065091

